

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.07.2022*

18.07.2022

Ora 12:00

RENDI I DITËS

Hedhja e shortit “Për caktimin e relatorit të kërkesës nr. 02 dhe nr. 03 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për vendosje sanksioni administrativ”, vendimi nr.180, dt.30.06.2022 dhe vendimi nr.182, dt.30.06.2022 të KSHZ”.

PJESËMARRJA:

- **Stafi KQZ: Y. Merkaj,**

Z. Y. Merkaj: Përshëndetje, fillojmë procedurën e hedhjes së shortit për dy kërkesat e Komisionerit referuar nenit 35 të rregullores së KAS. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka depozituar dy kërkesa për vendosje sanksion administrativ. Kërkesa nr. 02 datë 15.07.2022 dhe kërkesa nr. 03 datë 15.07.2022.

Ashtu siç është vepruar edhe në rastet e kaluara, kemi përgatitur pesë shirita letre, në dy prej të cilave janë vendosur kërkesat ankimore. Tre shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime. Viojmë më tej, pasi palosen shiritat, vendosen në pesë gogla me ngjyrë, formë dhe peshë të njëjtë, e më pas në një enë transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë prezent, kanë autorizuar një përfaqësues nga administrata e KQZ-së e cila pasi i trazon vazhdon me tërheqjen e goglave në emër dhe për llogari të anëtarëve të KAS-it, duke filluar nga rendi alfabetik rritës me z. Elvin Lako, z. Elvis Cefa, z. Ilirjan Rusmali, z. Koli Bele dhe në fund z. Ledio Braho. Vazhdojmë procedurën:

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvin Lako - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.18.07.2022*

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvis Çefa - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Vazhdojmë me goglat e tjera:

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ilirjan Rusmalit - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Koli Bele - shiriti përmban kërkesën ankimore nr. 02

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ledio Braho – në shiriti është kërkesa ankimore nr. 03

Atëherë, në përfundim të procedurës së shortit caktohet relator zoti Koli Bele i kërkesës nr. 02 dhe relator i kërkesës nr. 03 zoti Ledio Braho, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

